



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 689 / prot.  
AF

Elbasan, më 17.03.2025

VENDIM

Nr. 45, datë 17.03.2025

**"PËR  
HAPJEN E PROCESIT TË KANDIDIMIT PËR ANËTAR PËRFAQËSUES TË FAKULTETIT  
TË BIZNESIT DHE TË DREJTËSISË NË KOMISIONIN E APELIMIT DHE ANËTAR  
PËRFAQËSUES TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË EDUKIMIT NË KOMISIONIN  
INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT "ALEKSANDËR  
XHUVANI"**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Rregulloren e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Senati Akademik,

**Vendosi:**

1. Të shpallë hapjen e procesit të kandidimit për anëtar përfaqësues të Fakultetit të Biznesit dhe të Drejtësisë në Komisionin e Apelimit në Univesitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
2. Të drejtën për të aplikuar si kandidat për anëtar përfaqësues i Fakultetit të Biznesit dhe të Drejtësisë në Komisionin e Apelimit e kanë individët që janë anëtarë të personelit akademik në FBD, si dhe plotësojnë kriteret e mëposhtme:
  - a) Kanë përvojë pune në mësimdhënie, jo më pak se 5 vjet, me kohë të plotë;
  - b) Nuk kanë qenë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
3. Të shpallë hapjen e procesit të kandidimit për anëtar përfaqësues të dhe Fakultetit të Shkencave të Edukimit në Komisionin Institucional të Zgjedhjeve në Univesitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
4. Të drejtën për të aplikuar si kandidat për anëtar përfaqësues i Fakultetit të Shkencave të Edukimit në Komisionin Institucional të Zgjedhjeve e kanë individët që janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë në FSHE.
5. Afati i fundit i dorëzimit të dokumenteve për aplikim, është data 21.03.2025, ora 12.00.

6. Të interesuarit duhet të dorëzojnë pranë zyrës së Protokollit dokumentacionin e aplikimit:
  - a. Kërkesën për vetëkandidim.
  - b. Vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore.
  - c. Kopje të dokumentit të identifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Univesitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

